



**REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ**



Datë: 03.09.2026

PROCESVERBAL

**Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor me qytetarë, përfaqësues të fshatrave, grupe të interesit, OJQ, biznese etj. për Draftin e Buxhetit për vitin 2027
I mbajtur më 25.08.2026 (e martë)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi i përgjithshëm buxhetor me qytetarë, përfaqësues të fshatrave, grupe të interesit, OJQ, biznese etj. për Draftin e Buxhetit të vitit 2027 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën **11.08.2026**.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Kalendari-i-protokolluar-shqip.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Kalendari-i-protokolluar-boshnjakisht.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/195CGZEmkD/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1D8e7pPwMb/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/08/Njoftimi-i-protokolluar-1.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:00** dhe ka përfunduar në **ora 12:00**.

Në këtë Dëgim buxhetor kanë qenë prezentë **40 pjesëmarrës, prej tyre 32 meshkuj dhe 8 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini, i cili i ka përshëndetur të pranishmit.

Bexhet Xheladini: Siç e dini, për Qarkoren e Parë Buxhetore i kemi mbajtur dy debate publike. Për Qarkoren e Dytë, dje kemi mbajtur një debat publik me grupe të nënpërfaqësuar. Kurse sot kemi debatin e përgjithshëm me qytetarë, përfaqësues të fshatrave etj. Ne çdo vit organizojmë debate publike me qytetarë për buxhetin, sepse Buxheti është i qytetarëve, dhe ne sot ju kemi thirrur këtu që, së pari, ta bëjmë një prezantim të shkurtë për Buxhetin e vitit 2027 dhe projeksionet për dy vitet tjera, dhe pastaj do t'ju japim fjalën juve me i paraqit idetë dhe propozimet për projektet e ndryshme të investimeve kapitale. Ne do ta përgatisim Buxhetin bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, dhe legjislacionin në fuqi të cilin e ka miratuar Ministria e Financave, dhe duke u bazuar edhe në Statutin e Komunës. Buxheti i Komunës së Dragashit për vitin 2027 është **14,043,470 euro**. Krahasuar me vitin e kaluar, është një buxhet më i madh. Mirëpo, brenda këtij buxheti ka ndryshime në krahasim me vitin e kaluar. Siç e keni dëgjuar edhe përmes mjeteve të informimit, Qeveria e Kosovës, gjegjësisht Ministria e Financave, në vitin 2027 nuk do ta bëjë financimin e stafit të arsimit bazuar në stafin aktual që ka. Kemi marrë informatën që 115 punëtorë të arsimit janë si tepricë, dhe është marrë udhëzimi që nga 3 janari këta punëtorë të largohen nga puna, ose t'i mbajë Komuna me buxhetin e vet. Kështu që, për këtë qëllim, ne nuk kemi ardhë këtu me e çue askënd në shtëpi, kemi marrë një qëndrim që këta punëtorë të vazhdojnë të jenë edhe më tutje punëtorë të arsimit, por do të paguhen nga buxheti komunal. Në këtë drejtim, ne jemi të dëmtuar, sepse është dashtë që qeveria t'i mbulojë pagat, se është përgjegjësi e tyre. Kështu që ne, diku afër 900 mijë euro i kemi ndarë nga buxheti komunal dhe do t'i alokojmë në buxhetin për paga dhe shtesa për punëtorët e arsimit. Në këtë drejtim, do të kemi më pak mjete për investime kapitale, shpenzime komunale dhe mallra e shërbime. Buxheti për Paga këtë vit është **7,296,000 euro**. Bazuar në Qarkoren e Parë, ka një ndryshim, është pak më i madh, ku ka qenë 7,230,000 euro. Ekziston një dallim prej më shumë se 60 mijë euro. Por edhe këtu, qeveria, në vend se këto mjete t'i marrë nga buxheti i saj, prapë na i ka marrë komunave edhe i ka qit në listën e pagave. Është fjala për mbulimin e përqindjes së stazhit të punës. Siç e dini, Ligjin për pagat e ka përgatit kjo qeveri, edhe në atë ligj e ka ulë përqindjen e stazhit të punës nga 0.5 në 0.25. Kështu që tash, bazuar në vendimet e gjyqësorit, qeveria është detyruar që stazhin e punës ta kthejë në 0.5. Edhe në vend që këtë gabim që e kanë bo ta paguajnë ata, prapë qeveria na i ka marrë mjetet tona dhe i ka qit në buxhetin e pagave. Për Mallra dhe Shërbime do të jenë pak më tepër se **2 milionë euro**; për Shpenzime Komunale **400 mijë euro**; për Subvencione **591 mijë euro**, dhe për Investime Kapitale do të jenë **3,742,000 euro**. Buxhetin e investimeve kapitale,

ne si Komunë, bazuar në ligjet në fuqi, e ndajmë në mënyrë proporcionale me komunitetin joshumicë. Pra, 40% me 60%. Këtë ndarje të drejtë ne e kemi bërë që nga fillimi. Këtë e përmenda me qëllim që të jetë i njoftuar opinioni publik se, sa i përket ndarjes së buxhetit për investime kapitale, Komuna nuk bën asnjë diskriminim, sepse kohëve të fundit janë ngjallë edhe nacionalizmat, reagimet, në pjesën e komunitetit joshumicë, se gjoja ne nuk po i ndajmë mjete komunitetit. Kjo nuk është e vërtetë dhe kushdo mund ta vërtetojë. Unë më shumë nuk do ta zgjas, do t'ia jap fjalën edhe drjetorit të Buxhetit. Si thashë në fillim, qëllimi është që ta marrim edhe ide për shpërndarjen e buxhetit, por edhe propozime konkrete për investime kapitale në fshatrat tuaja. Faleminderit!

Qamil Kolloni: Përsëritet për të gjithë! Faleminderit që keni gjet kohë me marrë pjesë në këtë dëgjim buxhetor! Në pika të trasha, kryetari i tha të gjitha në përgjithësi, dhe vështirësitë buxhetore të cilat na janë paraqit këtë vit. Rrjedhojë e parë ka qenë numri i regjistrimit të popullatës, ju e dini se nga 34 mijë banorë kemi ra në 29 mijë, pra jemi ndër komunat me popullsi nën 30 mijë banorë, që në mënyrë automatike buxheti na është ndarë më pak. Ne 4%-shin e rritjes buxhetore nuk kemi arrit ta marrim, dhe ka afektue edhe numri i popullsisë, dhe gjithashtu për 960 mijë euro faktikisht jemi të dëmtuar në përgjithësi për vitin 2027. Këto mjete, siç tha kryetari, i kemi marrë nga investimet kapitale, që prekin drejtpërdrejt interesin e qytetarëve, me qëllim që t'i kompenzojmë këto humbje. Të gjitha këto kompenzime kemi arrit që, brenda këtij viti, t'i parashohim për vitin 2027 dhe të mos krijojmë probleme tjera më të mëdha. Gjithashtu edhe te problemet me Ligjin e pagave, të cilat nuk i ka paraparë si duhet Ministria, të gjitha pasojat i ka bart Komuna, që afekton në 66, 120 euro për stazhin e punës. Pra edhe këto mjete janë kompenzuar nga buxheti i Komunës dhe realisht kemi një buxhet të balancuar. Për të gjitha këto që tha kryetari, ju sot e keni mundësinë që të diskutoni, dhe të gjithë ata të cilët kanë propozime apo ide të na japin, kemi shumë diku afër 3,742,000 euro për investime kapitale, që mund t'i parashohim për vitin 2027. Edhe pse janë më pak në raport me vitin e kaluar, besoj që janë të mjaftueshme për me krye punë, sidomos për ato projektet më urgjente. Prandaj, për mos me humb shumë kohë, ne do t'jua japim fjalën juve, që ju të propozoni se ku mund të intervenojmë me këto mjete dhe cilat janë kërkesat më prioritare dhe, në shtator, kur të shkojë buxheti në Kuvend për miratim, mund t'i parashohim edhe propozimet tuaja të cilat janë të mundshme.

Uzair Hamza: Siç e keni dëgjuar tashmë gjatë prezantimit të parafolesve, kryetarit të komunës dhe drejtorit për buxhet, dëshiroj fillimisht të theksoj se një nga detyrat e Zyrës për Komunitete është të kujdeset që mjetet nga buxheti të shpërndahen në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes së komuniteteve joshumicë që jetojnë në territorin e Komunës së Dragashit. Siç e keni dëgjuar, për investime kapitale janë paraparë gjithsej 3 milionë e 808 mijë euro. Duke pasur parasysh se Dragashi është një mjedis i përbashkët, nga kjo shumë, 350 mijë euro do të investohen bashkërisht në Dragash

gjatë vitit 2027. Kjo do të thotë se për investime nëpër fshatra mbeten rreth 3 milionë e 460 mijë euro. Nëse zbatohet përqindja prej 40%, edhe pse sipas regjistrimit të fundit të popullsisë numri ynë është pak më i vogël, në fshatrat që u përkasin komuniteteve joshumicë do të investohen rreth 1.384.000 euro. Zyra për Komunitete, në bashkëpunim me përfaqësuesit e fshatrave dhe Drejtorinë e Urbanizmit, gjatë vitit pranon kërkesat e përfaqësuesve të fshatrave. Në bazë të këtyre kërkesave është hartuar lista e projekteve që duhet të realizohen në fshatra gjatë vitit 2027. Ajo që është e rëndësishme dhe që dëshiroj ta theksoj veçanërisht është se, kur flasim për komunitetet joshumicë, projektet duhet të propozohen nga vetë përfaqësuesit e fshatrave. Shpesh ndodh që në disa fshatra nuk kemi përfaqësues të zgjedhur, kështu që qytetarët vijnë individualisht dhe kërkesat e tyre ia drejtojnë kryetarit të komunës, drejtorit të Urbanizmit ose drejtorit të Zyrës për Komunitete. Kur flasim për ndarjen e buxhetit, mjetet për të cilat fola, përkatësisht rreth 1.384.000 euro, Zyra për Komunitete, në përputhje me përshkrimin e detyrave të saj, së bashku me përfaqësuesit e fshatrave, nënkryetarin e komunës për komunitetet joshumicë dhe drejtoritë e tjera, në bazë të kërkesave të përfaqësuesve të fshatrave, vendos se në cilat fshatra do të realizohen investimet kapitale dhe cilat projekte konkrete do të ndërtohen.

Më vjen keq që në debate të tilla publike, siç e theksoj shpesh, nuk ka shumë përfaqësues të komuniteteve joshumicë të pranishëm. Kur ndërtojmë projekte të caktuara, shpesh gjendemi në situatë që as vetë banorët nuk e dinë se çfarë po ndërtohet në të vërtetë. Kjo do të thotë se këshillat e fshatrave nuk bashkëpunojnë sa duhet me banorët, por kryesisht propozojnë projekte që u përshtaten atyre, përkatësisht projekte që kalojnë nëpër një rrugë të caktuar, ose propozohen për arsye të tjera, personale. Edhe një herë e theksoj: për ne janë të vlefshme vetëm kërkesat që vijnë nga përfaqësuesit e fshatrave, të cilët paraprakisht, në marrëveshje me banorët, kanë përcaktuar se cilat projekte do të realizohen gjatë vitit të ardhshëm dhe cilat janë prioritetet e fshatit të tyre. Në të kundërtën, ne si institucion nuk do t'i pranojmë projektet që vijnë nga individë. Për ne është shumë e rëndësishme që projektet që realizohen në fshatra të jenë nën mbikëqyrjen e komunës dhe të kryhen në mënyrë cilësore. Shpesh kemi ankesa dhe shqetësime nga qytetarët se projektet gjoja nuk janë kontrolluar në mënyrë adekuate. Megjithatë, çdo projekt ka menaxherin e tij, i cili, natyrisht, në përputhje me ligjin, është përgjegjës për përcjelljen dhe kontrollin e tij nga institucionet kompetente. Në mënyrë të detajuar, këtu i kam të dhënat për çdo fshat, përkatësisht se sa do të investohet në secilin fshat. Nëse më lejoni, shkurtimisht do t'i lexoj se në cilat fshatra do të realizohen investimet, përkatësisht ku do të investohen mjetet, apo do ta lëmë këtë për një rast tjetër.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! I kisha lutur të pranishmit, kush do me e marrë fjalën, le të urdhërojnë këtu në foltore, të prezantohet dhe të japë propozimet e veta!

Seat Ibraimi, përfaqësues nga Dragashi: Selam alejkum. I përshëndes të gjithë të pranishmit, si dhe të gjithë ata që morën pjesë në këtë debat, i cili, për fat të keq, është mjaft modest. Sipas mendimit tim, pjesëmarrja në takime të tilla duhet të jetë shumë më e madhe, sepse këto janë çështje shumë serioze dhe me rëndësi jetike për qytetarët. Ndarja e buxhetit është një çështje shumë e rëndësishme për çdo fshat dhe për vetë banorët, veçanërisht në zonat rurale. Prandaj, do të kërkoja që në mbledhjet e ardhshme të ketë sa më shumë të pranishëm nga të gjitha fshatrat, si nga Opoja, ashtu edhe nga Gora. Po dëgjoj këtu nga personat përgjegjës se buxheti për këtë vit është zvogëluar për shkak të vendimeve të Qeverisë, përkatësisht se Qeveria ka marrë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve nga komuna dhe në këtë mënyrë i ka ngarkuar komunës disa obligime që më parë nuk kanë ekzistuar. Do të ndalesha fillimisht te investimet kapitale për Dragashin. Unë jam banor i Dragashit, vij nga Dragashi i Poshtëm dhe jam kryetar i këshillit të Dragashit të Poshtëm. Më intereson një çështje: në mbledhjen e kaluar dëgjuam këtu nga drejtori se investimi kapital për Dragashin, në kuadër të këtij buxheti, është rregullimi i fasadave dhe kulmeve të ndërtesave. Sipas mendimit tim, kjo është një çështje shumë dytësore dhe e papranueshme për një investim kapital. Konsideroj se ende nuk është koha për zbulimin e diçkaje, sepse në Dragash, si qendër kryesore e komunës, ekzistojnë shumë çështje urgjente që janë me rëndësi jetike për qytetarët. Do të ndalesha fillimisht te ujësjellësi. E dini se ujësjellësi është ndërtuar dhe se atje lart gjithçka është rregulluar, gjë që me të vërtetë është për t'u lavdëruar. Mirëpo, përgjatë gjithë gjatësisë së rrjetit përmes Dragashit, ai është vendosur para shumë vitesh, nuk e di saktësisht se në cilin vit, dhe ajo që është më e keqja është se ky rrjet përdor gypa të azbestit. Këta gypa janë shumë të brishtë. Nëse kalon ndonjë kamion i rëndë ose nëse ndodh ndonjë ngarkesë më e madhe, ata çahen. Kemi çarje të shpeshta të gypave, dhe këtë mund ta konfirmojë edhe zoti që punon në ujësjellës. Përveç kësaj, dihet se gypat e azbestit paraqesin edhe problem shëndetësor. Prandaj, do t'u propozoja personave përgjegjës që ta marrin në konsideratë një investim kapital për Dragashin, i cili do të nënkuptonte zëvendësimin e këtyre gypave dhe rregullimin afatgjatë të rrjetit të ujësjellësit. Nuk po flas për sasinë e ujit, sepse uji varet edhe nga kushtet atmosferike dhe periudha e thatësisë, dhe kjo rregullohet në mënyra të tjera. Po flas për rrjetin nëpër Dragash, i cili është shumë i amortizuar, i brishtë dhe i parregulluar. Prandaj, do të kërkoja që në periudhën e ardhshme kjo të jetë një nga investimet kryesore në Dragash. Si përfaqësues i Dragashit të Poshtëm, kam edhe dy-tri çështje për të thënë. Unë jam pothuajse i pranishëm në çdo mbledhje të këtij lloji. Dhe, më besoni, tashmë më vjen turp që vazhdimisht të paraqes të njëjtën çështje. Ju keni pasur dy aksione atje poshtë, përkatësisht dy projekte: projektin e ndërtimit të parkut dhe projektin e ndërtimit të rrjetit të ujësjellësit

dhe kanalizimit, si dhe të rrugës atje poshtë, në drejtim të pjesës së rrethuar të komunës. Kanë kaluar tashmë tri vjet që këto objekte janë ndërtuar, por, për fat të keq, ende nuk janë përfunduar. Unë vazhdimisht, vazhdimisht këtu, nga kjo foltore, flas për këto projekte dhe me të vërtetë është e dhimbshme që vazhdimisht duhet të theksoj se këto objekte, përkatësisht këto projekte, duhet të përfundojnë. Gjatë ndërtimit të rrugës, rrugës kryesore që tani çon drejt stadiumit, ju, zotërinj, e dëmtuat rrugën tonë lokale që çon drejt varrezave. Unë, ashtu siç keni kërkuar, e kam dorëzuar zyrtarisht kërkesën për ndërtimin e murit mbështetës dhe ndërtimin e rrugës, sepse aktualisht nuk kemi qasje në varreza nga ana e poshtme. Varrezat tona janë të mëdha, kështu që aktualisht njerëzit varrosen vetëm në pjesën e sipërme, ndërsa pjesa e poshtme mbetet bosh, sepse nuk mund të arrijmë deri te vendet e varrimit. Dy-tri herë e kam dorëzuar të njëjtën kërkesë. Vazhdimisht thuhet se kërkesa është atje, se kohët e fundit ka ardhur një inxhinier dhe ka parë diçka, por nga e gjithë kjo nuk ka asgjë. Gjithmonë është pranverë, gjithmonë është verë, ndërsa se kur do të punohet, nuk e di. Megjithatë, mendoj se tashmë është përgjegjshmëri e personave përgjegjës që kjo rrugë drejt varrezave të mos realizohet. Realizohen rrugë nëpër male dhe nuk e di se ku tjetër, ndërsa një rrugë në vetë qendrën e komunës, për te varrezat, ne nuk e kemi. Do të kërkoja që ky projekt më në fund të realizohet dhe të përfundojë. Sa i përket ndarjes së buxhetit, përkatësisht shpërndarjes së buxhetit, nuk e di nëse ajo është në nivelin e duhur, por mendoj se nuk investohet sa duhet në Dragash, veçanërisht në Dragashin e Poshtëm. Ende në Dragash keni rrugë të paasfaltuara, nëpër të cilat njerëzit shkojnë deri te shtëpitë e tyre dhe ku edhe me automjete është vështirë të kalohet. Për fat të keq, ekzistojnë edhe probleme lokale, përkatësisht raste kur individë të caktuar nuk lejojnë ndërtimin ose zgjerimin e rrugëve. Megjithatë, mendoj se komuna mund ta marrë përgjegjësinë, ta shpallë interesin publik dhe të mundësojë që këto rrugë të hapen dhe të rregullohen. Sepse, më besoni, njerëzit atje jetojnë pa një rrugë të përshtatshme. Nuk mund të sjellin dru, madje kemi pasur edhe një situatë kur ambulanca e ndihmës së shpejtë nuk ka mundur të arrijë te një person i caktuar. Pra, mendoj se angazhimi i organeve komunale duhet të jetë në një nivel më të lartë dhe se probleme të tilla duhet të zgjidhen më seriozisht. Kaq nga ana ime. Ju falënderoj paraprakisht dhe mendoj se do t'i merrni parasysh këto që i paraqita.

Bexhet Xheladini: E falënderoj përfaqësuesin e Dragashit të Poshtëm, është një përfaqësues i cili vazhdimisht merr pjesë nëpër debate! Unë po i përgjigjem menjëherë kërkesave të tij. Sa u përket investimeve në ndërtesa, ky projekt veç është miratuar në Asamble dhe nuk mund të hiqet. Ma merr mendja që është një investim i qëlluar, sepse bëhet fjalë për disa ndërtesa kolektive ku askush nuk kujdeset për to. Pjesën më të madhe të mjeteve ne do ta shpenzojmë për renovimin e kulmeve, sepse ata banues që janë aty kanë hall dhe nuk po mund të merren vesh me bo investime të përbashkëta. Sa i përket ujësjellësit, ju e dini që rrjeti ekzistues është pronë e Hidroregjionit, dhe Komuna nuk ka

kurrfarë kompetence me prek në atë pronë. Por, kjo nuk do të thotë që Komuna nuk duhet me investue. Ne duhet të ulemi ma ta, me bisedue, me e bo një marrëveshje, me e bo një projekt të përbashkët, dhe me bashkëfinancim me investue. Ne jemi të gatshëm me u ulë me bisedue me Hidroregjionin, dhe me investue në rrjetin e ujësjellësit në periudhën e ardhshme, edhe me i hek gypat e azbestit. Sa i përket investimeve në Dragashin e Poshtëm, ne kemi bërë investime, ndoshta nuk janë të mjaftueshme, por kemi edhe pengesa pronësore, për hapjen e rrugëve të reja. Ne jemi në procedurë edhe në bisedime me personat nga Dragashi i Poshtëm, për hapjen e rrugëve të reja, dhe besoj që në një periudhë sa më të shkurtë Komuna do të ndërmarrë një iniciativë. Nëse nuk meremi vesh me ta, do t'i propozojmë Asamblesë Komunale që disa prona t'i shpallë si interes të përgjithshëm, dhe pastaj do të fillojë hapja, trasimi dhe kubëzimi i atyre rrugëve. Sa i përket rrugës te Varrezat, ju keni qenë, e keni bërë kërkesën, inxhinierët kanë qenë e kanë bërë projektin, projekti ka dalë në tender, edhe mjetet janë ndarë, dhe rruga për Varreza ka me u ndërtue sivjet.

Uzair Hamza: Ne kemi pasur dy takime me banorët e pjesës së poshtme të Dragashit, të cilët jetojnë dhe banojnë atje, para disa ditësh. Pas kësaj, kemi dalë në terren së bashku me kryetarin e komunës dhe drejtorin e Urbanizmit. Me atë rast kemi parë se ekzistojnë dy mundësi, përkatësisht dy raste ku, si të themi, dy qytetarë nuk lejojnë që rruga, respektivisht qasja, të kalojë nëpër pronën e tyre. Së bashku me ta jemi dakorduar që në periudhën e ardhshme të bisedojmë dhe të përdorim opsionin e fundit, që është shpallja e interesit publik dhe kompensimi me çmim të tregut, në mënyrë që të mundësohet hapja e rrugës. Ne tashmë jemi në këtë proces dhe nuk do të lejojmë që qytetarët të mbeten të bllokuar në këtë mënyrë dhe që të mos ketë mundësi të arrihet deri te shtëpitë e tyre.

Mytever Bojaxhiu, përfaqësues nga fshati Pllavë: Përshëndetje për të gjithë! Unë jam kryesues i Kryesisë së fshatit Pllavë. Ne i kemi disa kërkesa të cilat disa herë më radhë i kemi kërkuar, por si prioritet i kemi dy. Në fshatin Pllavë, në rrugën regjionale është krijuar njëfarë biznesi, është bërë një rrugë me biznese shumë të forta. Tash ne i kemi diku 15 firma, ne i kemi dhënë pronat tona që i kemi pas për bukë, i kemi dhënë për me i afrue bizneset, si për shembull Vivën, edhe kjo firma tjetër që ka me ardhë, Gorenje. Aty janë diku 200 punëtorë, që janë taksapagues, edhe këto firmat janë taksapaguese të kësaj Komune, dhe 200 punëtorë qarkullojnë në këtë rrugë, pa kurrënjëfarë trotuari. Kemi pas dy të vdekur, kemi pas disa lëndime tjera, edhe nuk është marrë ende ndonjë iniciativë për ndërtimin e trotuarit. Prioritet e kemi edhe rrugën e bjeshkës. Këto janë më kryesoret, kemi edhe gjëra tjera që na duhen, po këto janë më kryesore. Nëse si Komunë bëni investime nëpër fshatra, kisha me e cek që ata punëmarrësit të bashkëpunojnë me fshatrat, se ju jeni duke e bërë atë punën për fshatin. E ata që po punojnë, po i bëjnë punët shkel e shko, në qoftë se jau hekim ne një vërejtje, ajo është gabim. Ata duhet me e pas një kontrollim prej Komunës. Më mirë le të bëhet si duhet, ose të mos

bëhet hiç, se aty vetëm po gjuhet pare. Për shembull, kubëzimi që u bo, është bo katastrofal në disa vende, kanë fillue pa anësore me e bo kubëzimin. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Ne planifikojmë që, në periudhën dyvjeçare, në fshatin Pllavë të investojmë diku mbi 300 mijë euro, duke përfshirë mure mbrojtëse, kubëzime dhe trotuare. Me sa e di unë, projekti ka shkuar në tenderim, ndërsa sa i përket stadiumit, ai vetëm është në punim e sipër. Do të vendoset edhe bari artificial dhe do të bëhet një stadium modern. Nuk po e bëjmë trotuarin pse dikush po kërkon në Facebook, por sepse e keni bërë kërkesën zyrtare ju si fshat, dhe jemi bazuar në nevojën që ka ky fshat, për shkak të frekuentimit të shumë qytetarëve në këtë rrugë. Kur kam ardhë në mandatin e parë, kemi premtuar me e bo trotuarin, në vitin 2023. E kemi qit ekipin e inxhinierëve, dhe ne kemi dashur që ta bëjmë trotuarin – duke shkuar për Prizren, në anën e majtë – ka has në rezistencë të disa njerëzve, e kanë penguar dhe nuk na kanë lënë me e bo. Pastaj ka ndodhë zgjerimi i rrugës, që e ka bërë Ministria, edhe ata nuk na kanë lejuar më me vazhduar, se kanë thënë që kjo është kompetencë e Ministrisë. Ne kemi prit, masi nuk po e bën Ministria, do ta bëjmë ne, po kah ana e kundërt, kah e keni lyp ju.

Vullnet Dauti, përfaqësues nga fshati Xërxe: Ju përshëndes të gjithëve! Unë i kam disa kërkesa edhe një ankesë të vogël për fshatin Xërxe që e përfaqësoj. Ne, vitin e kaluar, prej buxhetit komunal nuk kemi pas investime në fshatin tonë hiç, ka kaluar krejt viti pa asnjë investim. Ne, projektet të cilat i bëjmë në fshatin tonë, mbajmë mbledhje. Bën vaki jemi prej shumë pak fshatrave, edhe me vullnet të shumicës së njerëzve që janë të pranishëm, merren vendimet edhe iu jepet prioritet projekteve të cilat i punojmë. Kisha pas dëshirë, prej njerëzve jashtë Kryesisë, të mos keni shumë njerëz që vijnë bëjnë kërkesa individuale për punime kolektive të fshatit. Ju e keni Regjistrin e Kryesisë së fshatit edhe prej atyre njerëzve vetëm me i marrë kërkesat. Për këtë vit, a keni ndërmend me investue, se gjithmonë në fshatin Xërxe, shumë fshat i vogël, lartësia mbidetare është e nalt, gjithmonë po na mbesin punimet e vonshme, edhe shkaku i motit të ligë, nuk po ka mundësi me u realizue projektet, po i zë viti tjetër. Edhe kemi pas fatkeqësi natyrore vitin e kaluar, kanë mbet ato në qat gjendje qysh janë. A ka mundësi Komuna me intervenue, me ndihmue me punue diçka? Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Sa i përket fatkeqësive natyrore, ju e dini që mbulimi i dëmeve nga to bëhet nga qeveria. Ne kemi bërë kërkesë në institucione përkatëse për me e bo mbulimin e këtyre dëmeve nga vërshimet, edhe në vitin 2024, edhe tash në këtë vit. Por, nga qeveria nuk kemi asnjë përgjigje. Kështu që, ne kemi ndarë mjete nga Komuna, për dëmet që janë shkaktuar në rrugën Xërxe-Pllajnik, rrëshqitjet e dheut që janë bërë. Tenderi ka dalë, sigurisht që këtë do ta marrë dikush dhe do ta kryejë. Gjithashtu, ka dalë edhe tenderi për rehabilitimin dhe rregullimin e rrugës Xërxe-Rrenc. Sa u përket kërkesave, ne çdo herë pranojmë kërkesa nga kryesia dhe nga kryetari. Dje e kam pas një

qytetar të Xërxes, ka ardhë drejtpërdrejt me bo kërkesë, e kam drejtuar te ju. A ka ardhë apo jo, nuk e di.

Remzi Misini, përfaqësues nga fshati Pllavë: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kryetar, unë po habitem me shumë gjëra, kurse ju për 80% të problemeve të fshatit Pllavë veç jeni në dijeni. Duke filluar prej kur keni qenë edhe drejtor i Administratës. Edhe, po habitem që janë disa punë urgjente që duhet atje në Pllavë të bëhen. Nuk janë bo! Devijimi i projekteve që është bo, ajo ka shukat, ato veç është dashtë me qenë punime të kryera. Ju e dini që unë disa projekte edhe i kam kundërshtue. Arsyeja ka qenë e bazuar, jo edhe ide e imja, po ka qenë ide e qytetarëve. Unë edhe atëherë kam thënë, edhe sot po them: në Pllavë, pa u bo petition për punime, gjithmonë ka qenë gabim. Petition nuk është lejuar me u bo, është punuar në mënyrë të fshehtë. Këtu përpara e kam edhe Zeniun unë, ai duhet me e ditë që na e kemi bo edhe një projekt të përbashkët Buqe-Pllavë. Një projekt ndërkombëtar që ka qenë me u lidhë fshatrat Brezne-Buqe-Pllavë-Rapçë. Edhe ai ka dështue, arsyeja dihet. Projekti ka qenë i dorëzuar edhe ka kalue. Nuk po due me i përmend tash të gjitha ato që duhet me urgjencë me intervenue në Pllavë, edhe pse jam i ftuar këtu, edhe më herët nuk kam marrë pjesë. Por sot, me presion të disa njerëzve që unë të vij, se jam përfaqësues i tyre, unë kam ardhë. Ndoshta kam gabue që kam ardhë, kërkoj falje. Ju uroj suksese, por me hesht nuk kam me hesht. Gjithmonë, ku të shoh aty që ka devijime, unë kam me e ngrit zërin. Kryetar, edhe një herë po të them, je i njohur më së paku 80% për problemet e fshatit Pllavë. Për qato probleme, edhe ju personalisht duhet me u marrë, edhe ato probleme me u zgjidhë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Unë nuk kam çka me u përgjigj kryetarit të Nëndegës së LDK-së fshatit Pllavë. Unë i dhashë informatat se çka do të bëhet në Pllavë. Ndërsa, sa i përket trasimit të rrugës që kemi dy vite që bisedojmë ne, pas këtij takimi, ju kisha lut, edhe ty, edhe juve përfaqësuesve të Pllavës, hajdeni te unë në zyrë, e bëjmë një bisedë tjetër.

Bekri Qusaj, përfaqësues i Dragashit: Përshëndetje të gjithëve! Kam marrë pjesë në shumë mbledhje në Komunë, në takime, edhe kemi dhënë mendimet tona për projektet. Kemi pas një bashkëpunim shumë të mirë me Komunën, edhe projektet janë realizuar gjithmonë në kohën e duhur. Ne si qytetarë, vitin e kaluar edhe këtë vit, prioritet e kemi një lagje, rruga që shkon për në fshatin Brod, tash atje veçse ndërtimi është shumë i lartë. Deri në vitin 2023, kanë qenë diku 60 shtëpi, të furnizuar me një gyp të ujit me 75-sh. Tash ajo lagje veç është në rritje e sipër edhe nuk ka furnizim të mjaftueshëm me ujë. Kemi rënë dakord që ta bëjmë një projekt bashkërisht me inxhinierët e ujësjellësit të Dragashit, ose të Prizrenit, të regjionit, në bashkëpunim me Komunën ta furnizojmë atë lagje me ujë. Kryetar, gjithë ato projekte që janë realizuar në Dragash, ju kisha lutur që të realizohet edhe ky projekt. Nëse ke mundësi – gjithë kohën kemi folë për ujin, për kubëzat, për rrugët, për kanalizime që

me të vërtetë kemi shtri në shumë lagje në Dragash, edhe të jam mirënjohës për këtë punë. Ku keni punuar mirë, është mirë. Vërejtje hala nuk kam për Dragash. Por, ju lutem që ta bëjmë një zgjidhje për këtë lagje, se më të vërtetë është e arsyeshme. Munden me e pa edhe inxhinierët e tu, ndërtimi i madh edhe kërkesat për ndërtim që janë bërë në Komunë me i marrë parasysh, edhe vetë me e vlerësue situatën se ajo lagje ka nevojë. Unë besoj prapë për një bashkëpunim më të hapur, të sinqertë, siç e kemi pas deri sot. Të jam mirënjohës për projektet e realizuara, aq ka qenë mundësia, aq kanë qenë mjetet. Por, të lutem, kije parasysh këtë lagje, se me të vërtetë kanë nevojë për ujë. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Në Dragash do të investohet edhe këtë vit, edhe vitin e ardhshëm, dhe unë e kam autorizuar Ylli Qafleshin, si inxhinier komunal, me u marrë me këtë çështje, e kisha lut që të dalë, me pika të shkurtra ta sqarojë se çka përfshijnë këto investime, se diku afër 250 mijë euro do të ndahen vetëm në këtë drejtim.

Ylli Qafleshi, inxhinier komunal: Përshëndetje për të gjithë! Jam marrë specifikisht me projektin e qytezës së Dragashit. Në këtë projekt gjithsej janë fut mbi 30 akse rrugore, i kam katër ose 5 akse që ka me u bo kanalizim fekal; i kam disa mure mbrojtëse; por është edhe një projekt tjetër tash, me kod buxhetor, që ka me u bo një pjesë e trotuareve, ka me u riparue. Te ky projekt po mendojmë me e fut edhe këtë ujësjellësin për këtë lagjen për të cilën foli Beka. Për momentin, vlera e këtij projekti që e kam përgatit është mbi 250 mijë euro. Faleminderit!

Florian Hyseni, përfaqësues nga fshati Shajne: Përshëndetje për të gjithë! Pasi që nuk po shoh përfaqësues të fshatit tim, e ndiej obligim moral që, si banor i fshatit, ta marr fjalën. Duke shprehur shqetësimin tonë lidhur me Rrugën Unazore, ku si banorë të fshatit Shajne kërkojmë që Rruga Unazore, nga Xhamia e Re e deri të ura e fshatit Shajne, të zgjerohet në tri korsi, me një parking publik në pjesën e poshtme të rrugës, saktësisht te ish-objektet e Pylltarisë. Kërkesë kjo, përveç nevojave tjera të fshatit Shajne, si instalimi i ri i ujësjellësit, deponitë ilegale të mbeturinave, rrugët e bjeshkës e shumë probleme tjera, për të cilat Kryesia e fshatit Shajne duhet sot të ishte këtu. Faleminderit!

Bexhet Xheladini: Faleminderit! Përveç kësaj me tri korsi që nuk e kuptova se për ku mendove, këto tjerat ne i kemi në plan edhe sivjet me i bo. Prej Xhamisë së Re këtu?! Edhe këtë me tri korsi kemi pas me e bo vitin e kaluar, por kemi probleme me pronat. Në fshatin Shajne do të bëhen investime edhe këtë vit, edhe vitin e ardhshëm. Por ju, sa më shpejt t'ia dorëzoni Florimit lokacionin për ndërtimin e këndit të lojërave për fëmijë. Ju kisha lutur, mundësisht bëjeni te shkolla. Por ju e dini më mirë. Mos e çoni lokacionin larg fshatit, se fëmijët nuk shkojnë atje. Sa më afër fëmijëve! Është çështje e juaja, e Kryesisë.

Atëherë, faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë takim!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/komuna-e-dragashit-ka-permbyllur-procesin-e-organizimit-te-degjimeve-buxhetore-per-draftin-e-buxhetit-komunal-per-vitin-2027/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/opstina-dragas-je-zavrila-proces-organizovanja-budzetskib-javnib-rasprava-o-nacrtu-opstinskog-budzeta-za-2027-godinu/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1BzSWVRGdP/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1HR3MGU1gX/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 400/01-18905/26/2
25.08.2026



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 25.08.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE NË DËGJIMIN E PËRGJITHSHËM
BUXHETOR ME QYTETARË, PËRFAQËSUES TË FSHATRAVE, GRUPE
TË INTERESIT, OJQ, BIZNESE ETJ.

LISTA UÇESNIKA NA OPŠTU BUDŽETSKO RASPRAVA SA
GRAĐANIMA, PREDSTAVNICIMA SELA, INTERESNIM GRUPAMA,
NVO, PREDUZEĆIMA ITD.

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička priпадnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	GAZMEN DANA	BRUÇ	SHQIPTAR	M		
2	MYTEVER BOJARI	PIHAN	SHQIPTAR	M		
3	ERMEDINA NERINI	DRAGAŠ	SHQIPTARE		✓	
4	Merybe Ramadani	Zaplluxhe	SHQIPTARE		✓	
5	Sehat Joraj	DRAGAŠ	SHQIPTAR	M		
6	Vullnet Dauti	Ed'xoxe	SHQIPTAR	M		
7	MUHSË KADRI	ORUZA	GORANKE	M		
8	KAMBER KANGOS	RAPCA	BOSNAK	M		
9	ROSHAT ALIJA	BLAC	SHQIPTAR	M		
10	BEHAR BRENOC	BRANOC	ROSHAK	M		
11	LIRIDONA HESHA	PLAVE	SHQIPTAR		✓	
12	Veton Hazizi	ZAPLUXHE	SHQIPTAR	M		
13	FLOKENT RUFATI	BRESANE	SHQIPTAR	M		
14	SELIM SALIHU	BRODOSANE	SHQIPTAR	M		
15	LIRIM KARMANI	BLAC	SHQIPTAR	M		
16	ARTAN JONUZI	BRESANE	SHQIPTAR	M		
17	VETIH HASANI	BRESANE	SHQIPTAR	M		
18	BEHAR SEJMANI	RAPCA	SHQIPTAR	M		
19	Zemir Krasniqi	BRUÇ	SHQIPTAR	M		
20	DILVER HAKIMOVI	MAJKE	GORANKA	M		
21	Bemti Mirim	PLAVE	SHQIPTAR	M		
22	VETON QAFESHI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	M		
23	Dreni Myrtezani	ZAPLUXHE	SHQIPTAR	M		
24	RAISA SABANI-JECMAZI	RAPCA	GORANKA		✓	

25	Arjeta Glesq	Rrunc	Shqiptare		F	Askeraj.
26	PAJAZIT ZHREH	GORA		✓		
27	CERKIL ZEDNEH	Shajm		✓		
28	Botendi Berisha	Ruse	Shqiptare	✓		
29	ARBIT KALANDER	Kosovë	Shqiptar	✓		
30	FLURIM KESHIMI	PRIZH	Shqiptar	✓		
31	Salirë Shumet	Shajm	Shqiptare		F	Shumet.
32	Emine Kurtashi	Dragan	Shqiptare		F	
33	LMALTA PIRAJ	Prizh	Ry		F	
34	Ben, Hoxhison	Broj	Shqiptar	✓		
35	Bekim Cusaj	Drejash	Shqiptar	✓		
36	FAR KALLONI	Kosovë	Shqiptar	✓		
37	KLORIAN HUGRI	Shajm	Shqiptar	✓		
38	Uzair Hamza	Kistuc	Bošnjak	✓		
39	Gamir Kallay	Kosovë	Shqiptar	✓		
40						
41						
42						
43						
44						
45	BEGIR BEQAJ	BELLOBRAD	044 391 700	✓		
46	RADIO SHARRI	DRAHAZH	049 391 700			
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						



